



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 393 Prot.

Tiranë, më 11.062015

VENDIM Nr. 51 datë 04.06.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, të datës 04.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Foinike"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues të tij Prof. Shpresa Gjongecaj dhe Prof. Sandro de Maria,

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Foinike"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues të tij Prof. Shpresa Gjongecaj dhe Prof. Sandro de Maria, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Kryerja e kërkimeve në tre sektorë kryesorë: a) Agora/Bazilikë; b) Vijimi me gjurmimet gjeofizike në zonën rreth sektorit lindor; c) ndërhyrje konservuese dhe konsoliduese në bashkëpunim me Parkun Arkeologjik të Phoinikes dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Vlorë/ Sarandë.
 - Në kuadër të projektit "Phoinike" të studiohet tempulli helenistiko-romak mbi teatrin e Butrintit.
- II. Para fillimit të gërmimeve, për heqjen e mbushjes humusore dhe në përfundim të punimeve për mbulimin e strukturave që do të rezultojnë të nevojshme për t'u mbuluar, të lejohet përdorimi i një makinerie (skrep) nën mbikqyrjen e rreptë të arkeologëve përgjegjes të projektit dhe DRKK-Vlorë.
- III. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë shtator 2015.



IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO